



Komiteti për shëndetësi dhe përkujdesje sociale

PROCESVERBAL

Mbledhja e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është mbajtur me datë **29.11.2023 (e premte)** me fillim në orën **08:35**.

Mbledhjen e dytë e kryesoi kryesuesja, znj. **Vlora Vuçiterna Çmega**.

Për këtë mbledhje, u propozua ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
3. Vizitë e QKMF-së, Rahovec;
4. Vizite e AMF-në, në lagjen e Komuniteteve;
5. Vizita e AMF-së, në lagjen e epërme në Rahovec.

Kryesuesja: Fillimisht përshëndetje për të gjithë! Pas leximit të rendit të ditës, po e vendosim në votim si të tillë. Kush është “pro”?... Me vota unanime miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja: A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “pro”?... Me shumicë unanime aprovohet pika e parë. Kalojmë në pikën e dytë!

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

A ka dikush të shtojë diçka sa i përket kësaj pike, nëse jo atëherë ne është mirë të lëvizim pasi si komitet duhet të shkojmë për vizita në QKMF-në e Rahovecit, AMF-në në lagjen e epërme dhe në AMF-në në lagjen e komuniteteve. Besoj se koha do na premtë, ne gjithmonë para mbledhjes i kemi kryer këto vizita. A ka dikush të shtojë edhe diçka, nëse jo, atëherë konstatoj që mbledhja ka përfunduar.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi



Kryesuesja e mbledhjes:

Vlora Vuçiterna - Çmega